



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 9/10 prot.

Datë 02/02/2024

V E N D I M
Nr. 128/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 02/02/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “Proçedurë e Hapur” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “Rikonstruksion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

Ankimues: Operatori Ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK, me NIPT: K71401004W.
Adresa: Rruga “Adem Jashari”, Nd. 4, Hrja 10, Nj Bashkiake nr.5, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Posta Shqiptare sh.a.
Adresa: Rr. “Reshit Çolloku”, Nr. 4 Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i

Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 09.11.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “Rikonstruksion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

II.2. Në datë 04.12.2023 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 20.12.2023 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “Eduart Cela” PF

00 leke

skualifikuar

2. “ERGI” SHPK	40,181,872.34 leke	skualifikuar
3. “Kevin Konstruksion” SHPK	41,562,884.16 leke	skualifikuar
4. “2N” SHPK	45.000,000.00 leke	skualifikuar
5. “CURRI” SHPK	48,817,300.67 leke	skualifikuar
6. “Liqeni VII” SHPK	49,013,341.00 leke	skualifikuar
7. “Llazo” SHPK	50,476,421.71 leke	kualifikuar
8. “AGRI CONSTRUCTION” SHPK	50,841,116.80 leke	skualifikuar

II.4. Në datën 20.12.2023, operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Nga shqyrtimi i dokumentacionit tekniko ligjor të ofertës së paraqitur në tender rezulton që nuk i përmbush plotësisht kriteret teknike për kualifikim dhe konkretisht:

Nuk plotëson; Pikën e Kapacitetit teknik, konkretisht pika 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme: -DSIK – Certifikate e sigurimit Industrial (CSI)

Nuk plotëson; Pikën e Kapacitetit teknik, konkretisht pika 2.3.3/b, Operatorët ekonomikë duhet të Paraqesë dëshmi për fuqinë puntore të operatorit ekonomik, b, OE duhet të disponojë punonjës të spëcializuar/kualifikuar, si më poshtë: duhet teknik ndërtimi . Për plotesimin e këtij kriteri ka deklaruar se do të mbështetet me kapacitet teknik nga shoqëria “ALBTIEFBAU” shpk, Nipt: J66703049C, por referuar dokumentave të tenderit për këtë procedurë, Seksioni 2, pika 2. 16, Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera, nuk pranohet. Pra nuk lejohet Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”, rezulton që oferta e operatorit ekonomik nuk Skualifikohet”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 29.12.2023 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak, duke shpallur fitues shoqërinë “LLAZO” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 03.01.2024 është protokolluar ankesa me nr. 9 prot., e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht paraqitur pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të

dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 9/2, datë 04.01.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Kevin Konstruktion” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me shkresën nr. 2215/14 prot, datë 10.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 9/3 prot datë 11.01.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Kevin Konstruktion” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit.

II.9. Me shkresën nr. 2215/15 prot, datë 11.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 9/4 prot datë 12.01.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes “Kevin Konstruktion” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimesit.

II.10. Referuar informacionit të sipërcituar të autoritetit kontraktor, rezulton se ky i fundit me shkresën nr. 2215/14 prot, datë 10.01.2024, si dhe shkresën nr. 2215/15 prot., datë 11.01.2024 ka vendosur:

“ [...] Lidhur me pretendimet e ngritura për dy kriteret që keni përmendur në ankesën tuaj të vendosura nga Autoriteti Kontraktor në “Dokumentat Standarte të Tenderit”, Ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Pretendimet e çdo Operatori Ekonomik të cilat kanë lidhje të drejtpërdrejtë me bazën e kriterëve api dhe hartimin e tyre, duhet të ezaurohen brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik. Sjellim në vëmendjen tuaj Nenin 110/pika 1 (Afatet e ankimit) të “Ligjit për Prokurimin Publik”ku parashikohet se:

.... Pra në rastin konkret Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka përfunduar fazën e vlerësimit të procedurës dhe ankësa që ju keni paraqitur fokusohet vetëm në ndryshimin e dy kriterëve në DST (dokumentat standarte të tenderit), ankesë e cila duhet të kishite ardhur pranë “Posta Shqipëtare” sh.a, në fazën e parë që i korrespondon asaj të hartimit të dokumentave të tenderit. Për çdo paqartësi në lidhje me ndryshimin e kriterëve të DST-së, theksojmë se ju kishit në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës për sqarime të nevojshme pranë Autoritetit Kontraktor deri në 10 (dhjetë) ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 110 i LPP-së.

Si konkluzion nga shqyrtimi i informacionit të administruar për çështjen objekt ankimi, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se pretendimet e ngritura nga ana Juaj në ankesë mbi kriteret e vendosura në DST nuk mund të bëhen objekt shqyrtimi në këtë fazë që ndodhemi pasi janë jashtë afateve të parashikuara nga Ligji i prokurimit Publik për depozitimin e ankesës.

Për sa më sipër, pretendimet tuaja të pasqyruara në ankesë nuk qëndrojnë.[...]”.

II.11. Me shkresën nr. 04 prot, datë 12.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 9/5 prot datë 15.01.2024, është depozituar nga ana e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Constrksion” SHPK në Komisionin e Prokurimit Publik, argument shtesë në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.12. Me anë të shkresës 9/6 prot., datë 18.01.2024, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

“Nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik “Kevin Constrksion” SHPK ankimues, konstatohet se objekti i ankimit ka të bëjë me skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit e sipërpërmendur në lidhje me kriterin 2.3.5 si më poshtë:

“2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- *Sistemi i menaxhimit të cilësisë (ISO 9001 – 2015 ose Ekuivalent) e vlefshme,*
- *Sistemi i menaxhimit të mjedisit (ISO 14001 – 2015 ose Ekuivalent) e vlefshme,*
- *Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë (OHSAS 18001 – 2007 ose Ekuivalent) ose ISO 45001-2018 ose Ekuivalent të vlefshme*
- *Sistemi i menaxhimit të integruar PASS 99-2012 ose Ekuivalent*
- *ISO 3834-2:2006 ose Ekuivalent Per cilësinë në saldim*
- ***DSIK – Certifikate e sigurimit Industrial (CSI)***

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.”

Për një shqyrtim sa më të drejtë të çështjes objekt-ankimi, kërkojmë nga ana juaj duke qenë se në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim nuk është shprehur qartë se përse është kërkuar Certifikata : “DSIK – Certifikate e sigurimit Industrial (CSI)”, një informacion më të detajuar në lidhje me vendosjen e këtij kriteri.”

II.13. Me shkresën nr. 2215/17 prot, datë 22.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 9/7 prot datë 22.01.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i kërkuar nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik si më poshtë vijon:

“... Sqarojmë se të dyja zyrat postare ku do të kryhen punime, janë zyra të cilat kanë një aktivitet i përditshëm shërbimi dhe nuk mund të boshatisen tërësisht materialet, dosjet që ndodhen në këto ambiente. Theksojmë se Zyra Postare qendër Tirana 5 në ndryshim nga zyrat e tjera postare, ka pjesë të saj fizikisht edhe Sektorin e Thesarit të Filialit Tiranë i cili ushtron veprimtarinë në ambientet e nëndheshme të kësaj zyre. Në këtë ambient bëhet grumbullimi i vlerave të konsiderueshme (arkëtim), përpunimi dhe shpërndarja e vlerave monetare për të gjithë zyrat e Degës të Filialit Tiranë. Gjithashtu nga kjo pikë nisen mjete e

blinduara, fondet e marra nga bankat e nivelit të dytë grumbullimi dhe shpërndarja vlerash monetare, që mundësojnë shpërndarjen për shërbimin e pensioneve.

Duke u ndodhur në këto kushte AK-ja kërkon mbrojtje ndaj çdo shkeljeje, shkatërrimi, përvetësimi, përhapje, humbje ose aksesit të ndonjë individi të paautorizuar dhe të çdolloj tjetër kompromentimi sigurie dokumentacionesh.”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se: “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoriteti kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MEDFAU” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se: “Nuk plotëson; Pikën e Kapacitetit teknik, konkretisht pika 2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme: -DSIK – Certifikate e sigurimit Industrial (CSI)”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.2. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik” në dokumentet e tenderit të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

“2.3.5 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Sistemi i menaxhimit të cilësisë (ISO 9001 – 2015 ose Ekuivalent) e vlefshme,
- Sistemi i menaxhimit të mjedisit (ISO 14001 – 2015 ose Ekuivalent) e vlefshme,

- *Sistemi i menaxhimit te shendetit dhe sigurimit ne pune (OHSAS 18001 – 2007 ose Ekuivalent) ose ISO 45001-2018 ose Ekuivalent te vlefshme*
- *Sistemi i menaxhimit te integruar PASS 99-2012 ose Ekuivalent*
- *ISO 3834-2:2006 ose Ekuivalent Per cilesine ne saldim*
- *DSIK – Certificate e sigurimit Industrial (CSI)*

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.”.

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.1.5. Në nenin 47 “Procedura e hapur” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“1. Procedura e hapur, sipas nenit 42, të LPP-së, është procedura e prokurimit me një fazë, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, me një vlerë mbi kufirin e ulët monetar.

2. Njoftimi i kontratës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimit elektronik dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike, në përputhje me nenin 56 të LPP-së dhe me këto rregulla.

3. Afatet kohore minimale për pranimin e ofertave për këtë procedurë janë ato të parashikuara në nenin 42, të LPP-së. Autoriteti/enti kontraktor mund të përlllogarisë afate më

të gjata se afatet minimale të përcaktuara në LPP, kur një gjë e tillë diktohet nga kompleksiteti i objektit të prokurimit apo kërkesave që do duhet të plotësojnë operatorët ekonomikë.

4. Pas mbarimit të afatit për paraqitjen e ofertave, të përcaktuar në njoftimin e kontratës, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 42 të LPP-së, autoriteti/ enti kontraktor hap ofertat, vlerëson dokumentacionin e ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave dhe përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87, të LPP-së.”.

III.1.6. Në nenin 39 pika 4, 6 dhe 8 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me vlerën totale të përlllogaritur të kontratës/ave.”.

III.1.7. Në nenin 10 “Kategoritë e klasifikimit” të Ligjit nr. 10/2023 datë 02.02.2023 “Për Informacionin e Klasifikuar”, i ndryshuar parashikohet se:

“Informacioni i nënshtrohet procesit të klasifikimit sipas niveleve të përcaktuara në këtë ligj për kategoritë e mëposhtme, kur lidhet me sigurinë kombëtare:

a) raporte, analiza, informacione të paraqitura në mbledhjet e Këshillit të Sigurimit Kombëtar dhe të komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë;

b) raporte, analiza, informacione, që shkëmbehen apo ndahen në takime dypalëshe ose shumëpalëshe me delegacionet e shteteve/organizatave të huaja dhe me strukturat shtetërore;

c) veprimtaria e shërbimeve informative, ku ekspozohen format dhe metodat e punës;

- c) burimet e informacionit në shërbimet informative dhe në strukturat e tjera parandaluese, gjurmuese dhe zbuluese;
- d) dokumentacioni i krijuar nga strukturat shtetërore gjatë veprimtarisë informuese, parandaluese, gjurmuese dhe zbuluese;
- dh) plane ushtarake, programe, harta, planimetri dhe informacione të tjera ushtarake, që përmbajnë të dhëna me rëndësi taktike, operative e strategjike;
- e) informacione për planet e mbrojtjes me rëndësi strategjike dhe kapacitetet e Forcave të Armatosura;
- ë) informacion që lidhet me ndërtimin, përbërjen, fortësinë, përdorimin e sistemeve, algoritmeve dhe materialeve kriptografike në të cilat trajtohet informacion i klasifikuar;
- f) vlerësimet strategjike të Forcave të Armatosura për kërcënimet, rreziqet dhe masat për përballimin e tyre;
- g) informacione për gatishmërinë luftarake, pajisjen, modernizimin, kompletimin me forca, mjete të Forcave të Armatosura;
- gj) çështjet kriptologjike, shkencore, teknologjike dhe ekonomike;
- h) informacionet lidhur me substancat e ndryshme kimike, biologjike, nukleare të rrezikshme për jetën dhe mjedisin;
- i) planimetritë, skemat dhe projektet për objektet e rëndësisë së veçantë;
- j) planet për sigurinë e personaliteteve të larta shtetërore të vendit dhe të huaja;
- k) programi për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të bashkëpunëtorëve të drejtësisë;
- l) veprimtaria e përgjimit parandalues të komunikimeve elektronike;
- ll) informacioni që lidhet me gjendjen, kapacitetin, operimin, vlerësimin e sigurisë, kërcënimet, dobësitë, riskun, incidente sigurie të sistemeve/pajisjeve që trajtojnë informacion të klasifikuar;
- m) planet dhe skemat e sigurisë fizike të zonave të sigurisë për informacionin e klasifikuar;
- n) planet e evakuimit të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, të NATO-s, BE-së, të shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare;
- nj) dokumentet që përmbajnë informacion të klasifikuar në prokurimet në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë;
- o) regjistrat dhe librat për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror” pas plotësimit të tyre.

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe hartimi i dokumenteve të tenderit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit te kriteret e veçanta për kualifikim kapaciteti teknik, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë: “*DSIK – Certificate e sigurimit Industrial (CSI)*”, ndërsa në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga

autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”. Ndërkohë në nenin 39 pikat 4 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”, ndërsa në nenin 10 “Kategoritë e klasifikimit” të Ligjit nr. 10/2023 “Për Informacionin e Klasifikuar” janë përcaktuar qartë kategoritë e klasifikimit. Nga sa më sipër KPP, vëren, se në tërësi kriteri i hartuar nga autoriteti kontraktor është diskriminues dhe në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore konkretisht me nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 39 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 10 të ligjit 10/2023 “Për Informacionin e Klasifikuar” duke mos respektuar në këtë mënyrë parimin e barazisë në trajtimin e operatorëve ekonomike dhe duke mos u ngarkuar atyre të njëjtat të drejta dhe detyrime. Konkretisht me vendosjen e kriterit lidhur me DSIK – Certifikate e sigurimit industrial (CSI), ku është përcaktuar që kriteri do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e kësaj çertifikate, KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka vënë subjektet në pozita pabarazie, pasi një përcaktim i tillë vjen në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore të mësipërcituara, pra autoriteti kontraktor nga njëra anë ka publikuar një procedurë të hapur referuar edhe nenit 47 “Procedura e hapur” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ndërkohë nga ana tjetër kushtin për të dorëzuar çertifikatën CSI e ka përcaktuar në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore, pasi qëllimi i parashikimit ligjor në nenin 39, pika 4, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, është të vendosë një rregull për autoritetin kontraktor sa i përket kriterëve të clët duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

KPP gjykon, se hartimi i kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 “Kapaciteti teknik” të shtojcës “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi në mënyrën e formuluar, e cila është në kundërshtim me parashikimet e nenit 39, pika 4 të VKM së sipërcituar, shkakton konfuzion në radhët e operatorëve ekonomikë dhe njëherazi në punën e KVO-së gjatë procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pasi nuk përputhet me qëllimin dhe frymën e dispozitës ligjore. Dispozita ligjore ka për qëllim të ndalojë autoritetet kontraktore të kërkojnë kriterë përtej natyrës së kontratës dhe në rastin konkret autoriteti kontraktor në asnjë moment nuk ka arritur të argumentojë se përse është kërkuar çertifikata CSI pasi në kthim përgjigje është shprehur se ky çertifikim është kërkuar për arsye se në ambientet e postës bëhet grumbullimi i vlerave të konsiderueshme, përpunimi dhe shpërndarja e vlerave monetare dhe se gjithashtu grumbullimin dhe shpërndarjen e vlerave monetare që mundësojnë shpërndarjen për shërbimin e pensioneve, dhe në asnjë moment se ku është mbështetur për vendosjen e këtij kriteri, pasi referuar nenit 10 të ligjit nr. 10/2023 “Për Informacionin e Klasifikuar” ku janë përcaktuar qartë fushat e zbatimit të legjislacionit për informacionin e klasifikuar në asnjë moment nuk përcaktohet se grumbullimi, përpunimi apo shpërndarja e vlerave monetare përbën informacion të klasifikuar. KPP gjykon, se me këtë kriter autoriteti kontraktor vjen në kundërshtim me frymën e ligjvënësit dhe me parashikimet ligjore të përcaktuara në nenin 77 të ligjit dhe në

neni 39 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke diskriminuar operatorët ekonomikë, duke shkelur parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë së kandidatëve dhe parimit të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe duke mos u ngarkuar operatorëve të njëjtat të drejta dhe detyrime.

Në këto kushte, KPP vëren parregullsi dhe paligjshmëri në lidhje me përcaktimin e kriterit mbi paraqitjen e DSIK – Çertifikatë e sigurimit Industrial (CSI). Lidhur me këtë konstatim KPP gjykon, se kriteret kualifikuese të procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen, të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i kriterit si në rastin konkret, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Në këto kushte KPP gjykon, se paqartësitë e krijuara në këtë rast për shkak të të metave të rëndësishme si ato të kriterëve në kundërshtim me frymën e ligjit dhe akteve nënligjore në hartimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit, përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.1.9. KPP gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikime thelbësore në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, pasi duhet të rishikojë kriterin në lidhje me çertifikatat në përputhje me parashikimet ligjore të nenin 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 39 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt-prokurimi, me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jodiskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

III.1.10. Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin”, nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji përcaktohet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj.”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimitarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë

plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procesi i hartimit dhe përcaktimit të dokumenteve standarde të tenderit konkretisht të xhiros, është bërë jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik për shkaqet e sipërcituara, ndaj përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit, me qëllim trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentet e tenderit janë haptazi jo në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik, ndaj, përbën shkak për anulimin e tyre. Në këto kushte, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi, duke hartuar, kriteret për kualifikim, në përputhje me nevojat reale dhe përcaktimet e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore të prokurimit publik. Në kushtet kur autoriteti kontraktues ka vlerësuar mbi kritere që bien në kundërshtim me frymën e ligjit të prokurimit publik, mbi të cilat ka bërë edhe vlerësimin dhe kualifikimin/skualifikimin e operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim, pasi procedura e prokurimit duhet të anulohet.

Sa me sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Kevin Contruksion” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të tij se: “.. Nuk plotëson; Pikën e Kapacitetit teknik, konkretisht pika 2.3.3/b, Operatorët ekonomikë duhet të Paraqesë dëshmi për fuqinë puntore të operatorit ekonomik, b, OE duhet të disponojë punonjës të spëcializuar/kualifikuar, si më poshtë: *duy teknik ndërtimi . Për plotësimin e këtij kriteri ka deklaruar se do të mbështetet me kapacitet teknik nga shoqëria “ALBTIEFBAU” shpk, Nipt: J66703049C, por referuar dokumentave të tenderit për këtë procedurë, Seksioni 2, pika 2. 16, Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera, nuk pranohet. Pra nuk lejohet Mbështetje në kapacitetet e subjekteve të tjera.*

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 53, pika 3 e ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar, ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”, rezulton që oferta e operatorit ekonomik nuk Skualifikohet” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, në pikën 2.3.3/b “Kapaciteti teknik” në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

a) “Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- Teknik Ndërtimi 2 (dy)
- Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit 1 (nje)
- Hidraulikë 2 (dy)

- Elektricistë 2 (dy)
- Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse 2 (dy)
- Hekurkthyes 1 (nje)
- Karpentier 2 (dy)
- Hidroizolues 2 (dy)
- Specialist gipsi 1 (një)
- Bojaxhi 2 (dy)
- Punonjës duro-alumini 1 (një)
- Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to 2 (dy)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, operatorët ekonomikë duhet të plotësojnë dhe të paraqesin tabelën me të dhënat si më poshtë :

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në R.Sh. ”.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK. ”.

III.2.2. Në seksionin 2.16. ”Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera të Dokumentave të Tenderit autoriteti kontraktor ka përcaktuar se:

” 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po **Jo**

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:
_____”.

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.4. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhironja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.2.5. Në nenin 84, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta.

2. Operatori ekonomik mund ta shfrytëzojë aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale vetëm nëse subjekti tjetër i kryen punët ose do t'i sigurojë shërbimet për të cilat kërkohet aftësi e tillë.

3. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

4. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të sigurohet se për subjektin, aftësinë e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skualifikimin ose përjashtimin e tij. Autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë operatorit ekonomik që të zëvendësojë subjektin që ndodhet në kushtet e skualifikimit apo të përjashtimit.

5. Nëse operatori ekonomik shfrytëzon aftësi nga subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e marrëveshjes.

6. Ndërkohë, në rastin kur operatorët ekonomikë mbështeten në kapacitetet e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojë oferta ose të paraqitet si një kandidat i vetëm.

7. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që detyra/punë/aspekte

kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjëri prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ofertues.”.

III.2.6. Në nenin 39 pika 4, 6 dhe 8 “Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose

b) që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

d) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në rastin e prokurimit të kontratave shumëvjeçare, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat për kualifikim në përputhje me vlerën totale të përlllogaritur të kontratës/ave.”.

III.2.7. Në nenin 90 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Operatori ekonomik, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

2. Kur një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai duhet:

- ta deklarojë një gjë të tillë që në dokumentet e ofertës;

- t'i vërtetojë me dokumentacion provues autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme.

- t'i provojë autoritetit/entit kontraktor se për subjektin, aftësinë, e të cilit e shfrytëzon operatori ekonomik, nuk ekzistojnë shkaqet për skuafikimin ose përjashtimin e tij nga procedura, sipas parashikimeve të nenit 76, të LPP-së.

- Në çdo rast, operatori ekonomik ofertues që dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, duhet të provojë se plotëson të paktën 50% të kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor.

3. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e ndonjë subjekti tjetër për të dëshmuar plotësimin e kushteve në lidhje me kualifikimet arsimore dhe profesionale, atëherë shërbimet, për të cilat kërkohet një aftësi e tillë ose punët do të kryhen nga subjekti tjetër.

4. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e një subjekti tjetër në lidhje me kushtet që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike dhe financiare, autoriteti ose enti kontraktor mund të kërkojë që operatori ekonomik dhe subjekti të ndërmarrin përgjegjësi solidare për zbatimin e kontratës.

5. Kur operatori ekonomik kërkon të mbështetet në aftësinë e subjekteve të tjera, pasi këta të fundit do të kryejnë furnizimet, punët ose shërbimet, për të cilat kërkohen këto kapacitete, atëherë grupi i operatorëve ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm.

6. Në rastin e kontratave të punëve, shërbimeve dhe vendosjes ose instalimit në kuadër të një kontrate furnizimi, autoriteti/enti kontraktor, mund të kërkojë që për kryerjen e detyrave/punëve/aspekteve kritike të kontratës të mos mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera por të përmbushen nga vetë ofertuesi. Ky informacion publikohet në dokumentet e tenderit.

7. Subjekti mbështetës nuk mund të jetë njëkohësisht edhe ofertues në procedurën e prokurimit.

Subjekti mbështetës nuk mund të mbështesë më shumë se një operator ekonomik në të njëjtën procedurë prokurimi.”

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.9. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik nga operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK konstaton, se ky i fundit ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, është dhënë informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik “Kevin Konstruktion” SHPK. Konkretisht, tek operatori ekonomik “ALBITIEFBAU” SHPK.

Referuar dokumenteve të tenderit, në shtojcën 8 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, në pjesën e fundit përcaktohet, se “në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në

kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës”.

KPP, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, gjykon, se autoriteti kontraktor në përzgjedhjen e kryer, ku me X ka shënuar JO në DST përkatësisht 2.16.

” 2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilin ofertuesi nuk lejohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po

Jo

x

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja:

Sa më sipër, autoriteti kontraktor mund të përcaktojë në dokumentet e tenderit, kufizimin për mbështetjen në kapacitete të operatorëve ekonomikë, në detyra, punë, aspekte kritike, që nuk lejohet mbështetja, duke i shprehur konkretisht ato.

Në rastin konkret, konstatohet, se me këtë përzgjedhje autoriteti kontraktor ka lënë të hapur zgjedhjen mbi mbështetjen në kapacitet, pasi referuar nenit 90 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera, është një e drejtë e operatorit e përcaktuar në ligj, neni 84 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ndaj bazuar në kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në rastin në fjalë, operatori ekonomik e ka përmbushur detyrimin e tij në përmbushjen e kësaj kërkesë, duke deklaruar mbështetjen në kapacitetet e subjektit “ALBITIEFBAU” SHPK, për më tepër autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit është mbështetur mbi një bazë ligjore të shfuqizuar dhe konkretisht në ligjin nr. 9643, datë 10.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku ky i fundit është shfuqizuar me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, te Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-86763-11-08-2023, me objekt: “Rikonstruksion Zyra Postare qendër Tirana 5, Zyra Postare qendër Durrës” me fond limit 58,439,437.16 Lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 04.12.2023 nga autoriteti kontraktor, Posta Shqiptare sh.a.

2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit për operatorin ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK dhe të korrigojë shkeljet e konstatuara më sipër.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Kevin Konstruksion” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

